

UNDEF

The United Nations
Democracy Fund



FNUD

Fonds des Nations Unies
pour la démocratie



Raport mbi realizimin e premtimeve elektorale të z. Dionis Imeraj, Kryetari i Bashkisë Dibër

Periudha Qershor 2019 – Shtator 2020

PROJEKTI

**“Ndjekja dhe verifikimi i
premtimeve të fushatës
zgjedhore në Shqipëri”**

Mbështetur nga:

**Fondi për Demokraci i Kombeve të
Bashkuara**

Për më tepër informacion vizitoni platformën online “Matësi Elektorat” (The Albanian Truth-o-Meter Platform):

www.matesielektor.al

Ju mirëpresim të kontribuoni me ide dhe sugjerime mbi shpenzimet/investimet buxhetore lokale apo të qeverisjes qendrore si dhe mbi premtimet elektorale të realizuara ose të parealizuara të të zgjedhurve lokalë dhe anëtarëve të qeverisë.

E-mail: rdakorca@gmail.com

Tel: + (355) 822 42626

Premtimet elektorale të z. Dionis Imeraj, Kryetari i Bashkisë Dibër (Qershor 2019)

1. Rikonstruksioni i plotë i qendrës rekreative për moshën e tretë dhe hartimi i planeve specifike të cilat do përmirësojnë jetesën aty;
2. Do të realizojmë rikonstruksionin e argjinaturës së liqenit të Gramës, në mënyrë që furnizimi me ujin vaditës për banorët e fshatrave që mbulon ky burim të mos ndërpritet;
3. Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e kanaleve vaditëse, për të përballuar më së miri vaditjen e tokave bujqësore;
4. Furnizimi me ujë të pijshëm në çdo shtëpi në fshatrat ku mungon;
5. Asfaltimi i rrugëve në brendësi të fshatrave për Njësinë Administrative Kastriot.

Burimi: <https://ata.gov.al/2019/06/16/diber-imeraj-do-te-vazhdojme-me-tej-me-projektet-dhe-punet/>

Premtime të arritura – Dionis Imeraj - Bashkia Dibër

1. Pastrimi dhe rehabilitimi i vend-depozitimeve ilegale e pikave problematike përgjatë aksit Peshkopi-Kala e Dodës, rrugës Lushe-Staravec-Shimçan dhe në fshatin Herbel të Njesisë Administrative Maqellarë.
2. Rikonstruksioni i rrugës Ceren-Radomirë, e përfunduar me të gjithë parametrat e nevojshëm.
3. Sistemimi dhe rehabilitimi i rrugës së fshatit Kallë, Njësia Administrative Sllovë.
4. Vendosja e shtyllave të ndriçimit në rrugën “Shehat Shehu”.
5. Shkollë e re 9-vjeçare në fshatin Kërcisht, Njësia Administrative Maqellarë.
6. Përfundon ndërtimi i ujësjellësit të fshatrave Pollozhan, Çetush, Rashnapojë, Dohoshisht dhe Tomin.
7. Sistemimi i plotë i rrugës që lidh qendrën e Njesisë Administrative Zall – Dardhë me fshatrat Lashkizë dhe Tartaj.
8. Sistemimi dhe rehabilitimi i rrugëve të brendshme të Njesisë Fushë Çidhën.
9. Rehabilitimi i segmentit rrugor prej 4 km në aksin Fushë Çidhën-Zall Dardhë-Zall Reç.
10. Sistemimi i rrugëve të brendshme të fshatrave Brezhdan dhe Zdojan të Njesisë Administrative Tomin.
11. Pastrimi i kanalit vaditës në fshatin Selane, Njësia Administrative Tomin.
12. Rikonstruksioni i kanalit Trepçë-Dovolan, me një gjatësi prej 130 m.
13. Rehabilitimi dhe sistemimi i rrugëve në fshatrat Kukaj dhe Kandërr, Njësia Administrative Kastriot.
14. Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit vaditës së fshatit Rrenz, Njësia Administrative Fushë Çidhën.
15. Hapja e një segmenti rrugor rreth 500 metra, që të çon tek varrezat e fshatit Zimur, Njësia Administrative Tomin.
16. Hapja e një kanali kullues rreth 200 m buzë lumit Drin, në fshatin Katund i Ri, Njësia Asministrative Luzni, i cili do t’i shërbejë vaditjes së 3 ha tokë bujqësore.

17. Rikonstruksioni i kanalit vaditës Trepçë-Dovolan, i cili shërben për vaditjen e 70 ha tokë bujqësore.
18. Sistemimi i kanaleve vaditëse që furnizohen nga prurjet e përroit të Gramës, në Fushë Çidhën.
19. Rehabilitimi i rezervuarit të fshatit Shimçan, Njësia Administrative Tomin.
20. Ndërtimi i shkallëve të reja të Kamenit.
21. Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit vaditës Llixha-Brezhdan dhe Llixha-Kandërr, të cilët shërbejnë për vaditjen e 320 hektarë tokë bujqësore në Njësine Administrative Tomin dhe Kastriot.
22. Shtrimi dhe sistemimi i rrugës që të çon tek Qendra Shëndetësore Maqellarë.
23. Pastrimi i vendgrumbullimit të inerteve, sistemimi i rrugës me material granil dhe ndërtimi i një muri mbajtës në hyrje të fshatit Vojnik, Njësia Administrative Maqellarë.
24. Pastrimi dhe rehabilitimi i kanalit të Setës, në të dy degëzimet e tij, i cili shërben për vaditjen e 1250 hektarë tokë bujqësore të NjA Arras, Fushë Çidhën, Kastriot dhe Zall Dardhë.
25. Pastrimi i kanalit ushqyes të liqenit të Trepçës në Njësine Administrative Melan.
26. Rehabilitimi i trotuareve në lagjet "Nazmi Rushiti" dhe "Gjok Doçi".
27. Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme dhe të jashtme në Qendrën Balneare Peshkopi.
28. Pastrimi i inerteve në dy vendgrumbullimet e mbeturinave në Maqellarë.
29. Pastrimi i kanalit furnizues të liqenit të fshatit Grevë, Njësia Administrative Melan.
30. Mbjellja e 40 vazove me bredha dekorativë në Unazën e Vogël të qytetit.
31. Rehabilitimi i rrugës dhe pastrimi i përroit të fshatit Brest i Epërm, Njësia Administrative Kastriot.
32. Sistemimi dhe pastrimi i mbetjeve urbane në rrugën e vjetër Pollozhan-Çëtush, Njësia Administrative Tomin.
33. Pastrimi i mbetjeve tek ura e Dohoshishtit, Njësia Administrative Tomin.
34. Rehabilitimi i rrugëve të brendshme në Njësine Administrative Fushë-Çidhën.
35. Punë intensive për lyerjen e shkollave në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Dibër.
36. Pastrimi i mbeturinave në zonat problematike të njësive administrative të Bashkisë Dibër si dhe vendosja e gjobave për të ndëshkuar hedhjet ilegale të mbeturinave.
37. Rehabilitimi i rrugëve, ndriçimit dhe ujësjellësit në fshatin turistik Rabdisht, Njësia Administrative Melan.
38. Pastrimi i liqenit të Fushës së Vogël në Njësine Administrative Maqellarë. Ky liqen, i cili kishte rreth 50 vite jashtë funksionit do të mundësojë ujitjen e rreth 300 ha tokë të këtij fshati.
39. Pastrimi i liqenit të Trenës në Njësine Administrative Melan.
40. Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Fiqiri Dine" në Maqellarë.
41. Rikonstruksioni i hapësirës së varrezave të qytetit dhe varrezave të dëshmorëve në Dibër.
42. Asfaltimi i 4 km rruge në fshatin Borovjan, Njësia Administrative Kastriot.
43. Asfaltimi i rrugës dhe sistemimi i trotuereve në lagjen "Aksion".
44. Shtrimi i më shumë se 15 000 m² pllaka dekorative në bulevardin kryesor të qytetit të Dibrës.
45. Asfaltimi i 1,5 km rrugë në fshatin Staravec, Njësia Administrative Tomin.

46. Pastrimi i inerteve pranë kontenerëve të mbetjeve urbane në zonën e Dobrovës, Unazës së Madhe dhe ish Grumbullimit.

Burimi 1: <https://www.facebook.com/BashkiaDiber1>

Burimi 2: <https://www.facebook.com/imerajdionis>

Premtimet pjesërisht të arritura (në proces)

1. Vijon puna për rikonstruksionin e sifonit të rezervuarit të fshatit Shumbat si dhe për rehabilitimin e kanalit ujitës Ngjare – Shumbat. Nga rehabilitimi i këtyre dy veprave ujitëse, do të përfitojnë 135 familje për vaditjen e 40 Ha tokë bujqësore.
2. Viojnë punimet në "Pedonalen e Re (Llixha)". Ky investim synon sistemimin e plotë të Përroit të Llixhave në segmentin nga Ura e Pazarit-Llixha dhe rikualifikimin urban të kësaj zone.
3. Vijon puna tek Kantieri i ujit në Peshkopi, për të garantuar furnizimin me ujë të pandërprerë për 20 230 banorët e qytetit të Peshkopisë dhe 1 200 banorët e Katundit të Ri brenda vitit 2021.
4. Vazhdon puna për rikonstruksionin e plotë të kanalit Llixha-Dobrovë me gjatësi 4 km.
5. Viojnë punimet për rikonstruksionin e plotë të godinës së Qendrës Kulturore për Fëmijë “Naim Plaku”
6. Vazhdon puna për rehabilitimin e rrjetit rrugor rural në fshatrat e Njesisë Administrative Lurë.
7. Vazhdon puna për rehabilitimin e rrugës së fshatit Trojak, Njësia Administrative Sllovë.
8. Vazhdon puna për rehabilitimin e segmentit rrugor që lidh fshatrat Kishavec dhe Kandërr, Njësia Administrative Kastriot.
9. Viojnë ndërhyrjet për rehabilitimin dhe sistemimin e segmentit rrugor Peshkopi-Bellovë, në fshatin Bellovë, Njësia Administrative Melan.
10. Vazhdojnë punimet për ujësjellësin e Gramës, që do të përmirësojë ndjeshëm furnizimin me ujë për 36 000 banorë në Peshkopi, Tomin dhe Kastriot.
11. Nis shtrimi i asfaltit në kilometrat e parë nga Tirana në Rrugën e Arbërit, veprën më të rëndësishme infrastrukturore, të shumëpritur nga ne Dibranët, e cila përveçse do të shkurtojë e lehtësojë ndjeshëm lëvizjen drejt Tiranës, do të sjellë tjetër impuls zhvillimi për Dibrën.

Burimi 1: <https://www.facebook.com/BashkiaDiber1>

Burimi 2: <https://www.facebook.com/imerajdionis>